



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0901**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së OE “BLENOR” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit të DMRR-së faza e II” me numër të prokurimit 205-25-6248-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) “MINISTRIA E INFRASTRUKTURES”, më 27/10/2025, mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet si pjeserishte e bazuar ankesa e “BLENOR” SH.P.K. me nr. 2025/0901, e datës 13/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit të DMRR-së faza e II”, me numër të prokurimit 205-25-6248-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “MINISTRIA E INFRASTRUKTURES”.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “MINISTRIA E INFRASTRUKTURES” për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit të DMRR-së faza e II”, me numër të prokurimit 205-25-6248-5-2-1.
3. Me qenë se ankesa e operatorve ekonomik ankues aprovohen si pjeserisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

#### ***-Faktet dhe rrethanat procedurale –***

Me 11.07.2025, “MINISTRIA E INFRASTRUKTURES” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i objektit të DMRR-së faza e II” me numër të prokurimit: 205-25-6248-5-2-1, ndërsa me datën 05.09.2025 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 për dhenie. E “ArcumStudio

SH.P.K.”- Prishtinë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 40,000.00 €

Me 09.09.2025, OE “BLENOR” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 12.09.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “BLENOR” SH.P.K me nr. 2025/0901 lidhur me aktivitetin “Renovimi i objektit të DMRR-së faza e II” me numër të prokurimit: 205-25-6248-5-2-1.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: PËRGGJIGJE E PRETENDIMEVE ANKIMORE:

Pas shqyrtimi të pretendimeve ankimore, ju njoftomë se OE i rekomanduar i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në FDT duke përfshirë edhe inxhinieret në fjalë duke ofruar dëshmitë sipas kërkesave të përcaktuara në DT dhe Njoftim për Kontratë. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka qenë edhe oferta e përgjegjshme me Gmimin me të lire. Andaj pretendimet tuaja ankimore refuzohen. Kërkesa e juaj për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BLENOR” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pas kërkesave për qasje në dokumenta zyrtare dhe fillimit të shiqimit të dokumentacionit për OE të propozuar për dhenie të kontratës kemi vërejtur se i mungojnë disa nga dokumentet (kualifikimet e sfiatit profesional) të cilat kanë qenë kërkesë e dosjeve të tenderit.

9.1 & 9.2 : Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Menaxheri i projektit Të jetë inxhinier (arkitekt) i diplomuar 3 vite përvojë punë pas diplomimit. në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të objekteve të natyrës së njëjtë.

4. Inxhinier të Elektroteknikës i diplomuar me 3 vite përvojë punë pas diplomimit.

ni projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të objekteve të natyrës së njëjtë.

Sikur Arkitekti ( menaxheri i OE) ashtu edhe bachelori i Elektroteknikës nuk e kanë kualifikimin e kërkuar\_

Qe te dy jan me titullin arsimor Bachelor ndersa kerkesa ne DT siq shihet me larte te kapacitetet teknike dhe profesionale eshte kerkuar (Inxhiner),si deshmi keni te bashkangiiur edhe Diplomen perkatëse.

Gjeni te bashkangiiur ne PDF argumentet tona.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Eshte shkelur neni .7 Barazia ne trajtim/ Jo —Diskriminimi Eshte shkelur neni \_ 59 egzamimimi , Vlersimi dhe Krahasimi i Tenderev Eshte shkelur neni 69. Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale. Kerkoj nga OSHP qe kerkesen tone ta aprovoj si te bazuar dhe lenda te kthehet ne rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 15.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0901/25, ndërsa me datë 26.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0901 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk ka dhen pergjigje rreth raportit te ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “BLENOR” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0901 ka vlerësuar si në vijim:

Pergjigjet e ekspertit shqyrtues në pretendimet ankimore

Eksperti shqyrtues, pas verifikimit një nga një të dokumenteve lidhur me pretendimet ankimore, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe aktet ligjore sekondare të Rregullores për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), dhe në dokumentacionin e dosjes së tenderit, me theks të veçantë në kërkesat në FDT ofertata e palëve, konstaton sa vijon:

Pretendimet e palës ankuese

Kërkesat në dosjen e tenderit përkatësisht në FDT:

Eksperti shqyrtues – duke analizuar pretendimet ankimore të palës ankuese, dokumentet e ofertës së rekomanduar për kontratë, e më saktësisht pretendimet ankimore për kërkesat mbi mundësin teknike / profesionale, konstatoj se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dokumentet për stafin profesional: Vendimin për menaxherin të projektit, kontratën e punës, diplomën dhe dokumentet dëshmi për përvojën e punës.

Eksperti shqyrtues, duke analizuar pretendimet ankimore të palës ankuese, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, lidhur me kualifikimet e stafit profesional të kërkuar, konstaton si më poshtë:

#### 1. Menaxheri i projektit

Sipas dosjes së tenderit (FTD), kërkesa ka qenë që menaxheri i projektit të jetë inxhinier (arkitekt) i diplomuar, me së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit, në projekte të ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të objekteve të natyrës së njëjtë.

Operatori ekonomik i rekomanduar ka paraqitur diplomën e lëshuar nga Kolegji UBT – Fakulteti i Arkitekturës, me të cilën kandidati ka fituar gradën Bachelor i Shkencave në Arkitekturë (Niveli 6 i KKK, 180 ECTS), me datë 26.06.2020.

Kjo diplomë vërteton se kandidati është arkitekt i diplomuar, dhe duke qenë se në FTD nuk është përcaktuar që menaxheri i projektit duhet të ketë gradë Master apo licencë nga Oda e Arkitektëve, diploma në nivel Bachelor konsiderohet e mjaftueshme

#### 2. Inxhinieri i Elektroteknikës

Sipas FTD, kërkohet që inxhinieri i elektroteknikës të jetë i diplomuar, me së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme.

Operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar diplomë universitare në nivel Bachelor në Elektroteknikë, e cila përmbush kushtin. Në FTD të dosjes së tenderit nuk janë specifikuar grada më të larta si (Master) apo licencë profesionale. Përvoja e punës duhet të dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, të cilat janë pjesë e dosjes së ofertës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe pretendimeve ankimore, konstatohet se: Diplomat në nivel Bachelor të paraqitura për të dy pozitat e stafit profesional (Arkitekt dhe Inxhinier i Elektroteknikës) janë në përputhje me kërkesat e FTD, përderisa në dokumentacion nuk është përcaktuar kërkesa për gradë më të lartë ose licencë profesionale.

Prandaj, sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, pretendimet ankimore të palës ankuese në lidhje me kualifikimin e stafit profesional (Arkitekt dhe Inxhinier i Elektroteknikës) janë të pabazuara.

#### **- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –**

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit,

përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Reporting e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish. Mirpo aprovon ankesën si pjesërisht të bazuar për faktin se AK-ja në kërkesat e përcaktuara ka përkrahimin e Injginjerit, mirpo jo edhe Injginjeri i Diplomuar, mirpo ka lene hapsirë që në kuader të profesioneve të kerkura sikurse tek përkrahimi i menaxherit të projektit ku citohet Injginjer ( Artitektit ), dhe Injginjeri i Elektroteknikes, por jo edhe i diplomuar, i cili do ta ndryshonte titullin e fituar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi B58 “Njoftimin mbi vendimin e AK-së” nga Autoritetit Kontraktues – “MINISTRIA E INFRASTRUKTURES” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i objektit të DMRR-së faza e II” me nr. të prokurimit: 205-25-6248-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- **OE - BLENOR SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: